

01-030/01-0006248/19
2
28.01.19
Mitrovicë - Mitrovica

TRUPA-NORMIMIT
TRUPA-PREDULEÇE PËR ADMINISTRACION
TRUPÇA-PREDULEÇE PËR ADMINISTRACION
N. 16/ Data 28.01.2019
MITROVICË



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Jugore

Ndërmarrja shoqërore
“Trepça” SH.A

MARRËVESHJE

Për bashkëfinancim me qëllim të realizimit të projektit “Obelisku” i tridhjetë vjetorit të Grevës së Minatorëve, e lidhur:

në mes

Komunës së Mitrovicë, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës
z. Agim BAHTIRI

dhe

Ndërmarrjes shoqërore “Trepça” SH.A. të cilën e përfaqëson
U.D. z. Xhevdet TAHIRI

I. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj marrëveshje është realizimi i projektit, punimi dhe vendosja e “Obeliskut”, me rastin e përvjetorit të tridhjetë të Grevës së Minatorëve me pëlqimin e plotë të të dy palëve të shënuara si më lart, përmes një financimi të përbashkët.

Vlera e projektit: 8,800.00 €, (tetëmijë e tetëqind euro).

II. PËRGJEGJËSITË E PALËVE

- II. 1. Komuna do të kontriboj në realizimin e projektit në shumë totale prej 8.000,00 € (tetëmijë euro) nga buxheti i saj, përkatësisht nga Kodi për Bashkëfinancim.
- II. 2. Komuna, respektivisht Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm obligohet që të përcjellë realizimin e projektit dhe t'i raportoj Kryetarit të Komunës
- II. 3. Komuna zohohet t'i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme procedurale lidhur me përzgjedhjen e operatorit ekonomik, për punimin dhe vendosjen e pllakës përkujtimore në bazë të procedurave të prokurimit.
- II. 4. Ndërmarrja shoqërore “Trepça” SH.A. do të kontriboj me mjete financiare në shumë prej 800,00 € (tetëqind euro) për punimin e pllakës së Obeliskut të lartcekur.



II. 5. Ndërmarrja shoqërore "Trepça" SH.A., obligohet që mjetet financiare t'i derdh në xhirollogarinë bankare të Komunës së Mitrovicës së Jugut, në BQK, Nr. 1000-650180-0000-59, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje në shumën e cekur në paragrafin II.4.

II. 6. Ndërmarrja shoqërore "Trepça" SH.A., obligohet t'i ofrojë komunës bashkëpunim për verifikimin e emrave dhe ofrimin e të dhënave të minatorëve që kanë qenë pjesëmarrës në grevë që do të shënohen në pllakën përkujtimore.

III. DATA E HYRJES NË FUQI DHE NËNSHKRIMI

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët dhe qëndron në fuqi deri në përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga vetë Marrëveshja.

Çdo ndryshim i këtij Marrëveshje miratohet me shkrim nga të dyja Palët.

Rënë dakord dhe nënshkruar në Mitrovicë, më dt. 28.01.2019, në dy (2) ekzemplar identik, të mjaftueshme për palët kontraktuese.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës

Z. Agim BAHTIR



U.D. Drejtori i Ndërmarrjes shoqërore
"Trepça" SH.A.

Z. Xhevdet TAHIRI

